ADEM ZAPLLUZHA

PIKËLLIMET E RRËNJËVE

Redaktor:
Nikollë Loka

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Veli Veliu

Ballina:
Yllka Ibra

ADEM ZAPLLUZHA

PIKËLLIMET E RRËNJËVE

"TREND"
2017

Vëllimi poetik “Pikëllimi i rrënjëve” i Adem Zaplluzhës, metaforë e vijimësisë së të shkuarës në të tashmen

Nikollë Loka

Kur merr dhe lexon vëllimin poetik “Pikëllimet e rrënjëve” të poetit Adem Zaplluzha dhe mediton mbi të, teksa sheh mjeshtërinë e lartë artistike, lëmimin e vargut, lidhjen organike ndërmjet poezive në një libër të arrirë, me të drejtë kujton se autori ka jetuar gjatë me veprën e tij. Po nuk është ashtu, Ademi ka arritur në veprën e 150 letrare dhe vetëm gjatë vitit 2015 kishte botuar 14 vëllime poetike dhe këtë vit disa libra të tjerë në poezi dhe prozë. Kur e mendon sasinë e lartë të prodhimtarisë së tij, kujton edhe pamundësinë e autorit që të japë vepra cilësore. Por, teksa Zaplluzha rend pas sasisë, ka pretendime të larta për cilësinë. Këtë e pashë, jo pa habi në vëllimin poetik që keni në dorë. Atëherë m’u krijua ideja që kemi të bëjmë me një krijues përtej të zakonshmes, një fenomen letrar, për të cilin kritika e specializuar e ka thënë dhe do ta thotë fjalën e vet.

Kur lexon vëllimin poetik “Pikëllimet e rrënjëve” të poetit Adem Zaplluzha kalon në një zbulim të pavetëdijshëm të vetes dhe ndërsa udhëton nëpër labirinthe realitetesh jetësore, e ndjen simbolikën e pikëllimit të rrënjëve. Fjala në poezinë e Zaplluzhës

është urë lidhëse në kohë; identitet, thelb dhe asht, kod përbashkues vlerash të shpërndara e të zvetnuara nga koha. Fjala nuk vdes, ajo e zhbën kohën dhe simbolikisht lëviz, duke komunikuar me të shkuarën dhe të ardhmen.

Në poezinë e Zaplluzhës shprehen raportet me kohën, ku e shkuara vjen në një formë tjetër në të tashmen, duke lënë po ato gjurmë të së kaluarës që i mbajmë ende të ndezura në shqisat tona. Na duket se jetojmë në një të tashme, që pak na bën ta ndihemi se po jetojmë tani. Në poezinë e Zaplluzhës qenia kërkon të shkojë në thelbin e vet, ndërkohë që forca shkatërruese të jashtme nuk vijnë për ta ndryshuar gjendjen, por për ta ruajtur atë.

Poeti është mjeshtër në teknikat poetike, shprehje e përvojës së gjatë krijuese. Përdorimi i metaforës në poezi është një nga aspektet më të rëndësishme të stilit poetik. Në poezinë e Zaplluzhës, metaforat e zgjedhura me shije të lartë artistike shërbejnë për të shprehur emocionet sipërore, ndjenja e përziera, marrëdhëniet e ndërlikuara, që kërkojnë të dalin përtej shprehjeve të përditshmërisë. Metafora e Zaplluzhës shprehet në shumëkuptimësi e në disa nivele në poezitë e tij, duke bërë që vëllimi poetik, nga njëra poezi në tjetrën, të ketë vijueshmëri perceptimesh, emocionesh e mendimesh, të lidhura rreth idesë kryesore, atij, pra "pikëllimit të rrënjëve". Kemi një të tashme të zhytur në rrënjë: lejlekë që enden, vjeshtë gri, shi vrastar, përrua i çmendur, lehje drurësh, kuaj të verbër, xhama të

palarë të kujtesës, etj. Përsëritja e metaforave nga njëra poezi në tjetrën i jep vëllimit poetic thellësi dhe kompleksitetit të brendshëm. Metafora në poezinë e Zaplluzhës i ofron lexuesit mënyrat freskëta e shqyrtimit të ideve dhe këndvështrim origjinal dhe befasues të botës. Në këtë vëllim idetë kombinohen në mënyrë të veçantë dhe të rastësishme, ndërsa teknikat letrare janë përdorur si mjet i shprehjes së një kuptimi artistik nëpërmjet gjuhës.

Shiu, i cili u ngjante fjalëve të grisura/ rri si një buf/ mbi çatinë e shembur të kujtesës/ Deri sa hëna e çmendur/ në një gjysmë rrethi magjik/ vallëzonte me meteorët endacakë//.

Simbolika në letërsi është një lëvizje komplekse që qëllimisht zgjeron fuqinë ndjellëse të fjalëve për të shprehur ndjenjat dhe gjendjet e mendjes që shtrihen përtej vetëdijes së përditshme, duke projektuar ndjenjat e brendshme në botën e jashtme. Në poezinë e Zaplluzhës shiu nuk vjen për të gjallëruar, por për të asgjësuar dhe prishur gjendjen. Poezia ndërtohet mbi aksin kohor të raporteve të njeriut me kohën; e shkuara identitare me të tashmen, që shkon paradoksalisht në të shkuarën, sepse e tashmja me shi, rrebesh, shpëlarje të kujtesës, nuk na çon kah ardhmëria.

Në poezinë “Trokasim në dritaret e drynave të dylltë”, poeti i vendos dry të hekurt kohës. Ajo që e hap këtë derë dylli është fjala. Këtu fjala nuk vdes, ajo e zhbën kohën dhe vjen si dëshmi e saj. “As

pëshpëritje nuk ka; kur vdesin fjalët nuk ndizet qiriu" shprehet poeti.
Dritarja në poezinë e Zaplluzhës simbolizon fluturimin. Ja si vjen ajo në vargjet e një poezie : Kur i humbim fjalët/ ose mbesim si koçan i mykur në bahçe/ dalim nga kujtesa dhe trokasim/në të gjithë portat e hapura/ trokasim në dritaret e drynave të dylltë//.

Poeti nuk dëshiron të hyjë rrëshqanthi nga toka në bujtinën e vet, por nga dritarja, andej nga hyn drita dhe jeta. Ai shprehet se "nuk na e kanë mbyllur derën, por dritaret kanë dryna të dylltë". Dera nuk merr përmasa drite, ajo është vendosur afër tokës dhe nuk është e përzgjedhura e poetit. Ndryshe dritarja, ajo flet shumë që nga emërtimi dhe funksioni simbolik i saj, si e vetmja portë, ky hyn ardhmëria. Simbolika e dritares rimerret në poezinë tjetër "Të thashë mos i mbyll dritaret". Kjo poezi është një thirrje e kujtesës. Ajo na kujton se koha e mbështjell kujtesën me harresë. Poeti kërkon që të mos e mbyllim dritaren e kohës, se po të ndodhë kjo, do të bjerrim thelbin identitar e në atë gjendje, natyrshëm vjen thirrja:
Të thashë mos i mbyll dritaret/ nëse i dëgjon të trokiturat/ Hape mendjen/ bëri sytë katër si kokrrat e ullirit/ Te pragu do pres si baba dimri/ Është koha për t'i kyçur dritat e bredhit//.

Imazhet poetike e bëjnë poezinë e Zaplluzhës interesante. Poeti është mjeshtër i përdorimit të detajeve ndijore, i një shtrese kuptimësore më të thellë të simbolikës së poezive të tij.

Do të dal sot në dritë/ do qëndroj ulur te pragu i dhimbjes/ aty ku zënë fill mëkatet/ Me një gazetë të vjetër në dorë/ do i përzë mizat e bezdisshme//.

Poezia e Zaplluzhës është shprehje e gjendjes dhe nuk merr përsipër transformimin e saj. Poeti është fatalist. “Fara e keqe po mbin”, - shprehet ai, dhe në atë realitet poetik nuk mund të marrë frymë, i dhemb truri, ndjenjat i janë dobësuar, i grimcohen thonjtë, shkurt po vuan.
Poeti e ruan vuajtjen për vete, i bindur se është një vuajtje kolektive, ndaj të cilës kombi si organizëm i gjallë duhet të veprojë si një organizëm i gjallë përmes sistemit imunitar të vetëmbrojtjes.
Poeti Zaplluzha reflekton mbi forcën e të keqes, duke e parë të tashmen jo si “ruajtëse e vlerave”, por si “mbjellëse të farës së keqe”. Mbijetesën shqiptare poeti e përcjell në kohë, gjithmonë me plagë të pambyllura, kur sapo zë të shërohen të vjetrat, lindin plagë të reja, si pjesë e fatalitetit tone ende në udhëkryq.
Autori e përdor me mjeshtëri simbolikën e lisit dhe të rrapit që vetvetiu lidhen me simbolikën e rrënjë që mundësojnë qëndrimin në këmbë.

Në ciklin e dytë "Përveç kollitjes së drynave" kemi një reflektim mbi fatin e njeriut që e ndjek nga pas atë. Këtu dhimbja nuk kthehet në forcë, e keqja nuk zhduket, fataliteti nuk shndërrohet në sfidë, por ngelet si gjendje dhe pamundësi. Kollitja e drynave është një metaforë e pamundësisë së hapjes së dyerve, se kur "kolliten drynat" dera nuk mund të hapet më kurrë.
Ky cikël poetik shpreh një të tashme të zhbërë, me fatin tragjik që e përcjell, si një pamundësi për kapërcimin e gjendjes. Vetë titulli i ciklit jep përpjekjen për t'i ikur fatit. Në poezinë "Përveç kollitjes së drynave" autori ndër të tjera shprehet:
Nëpër rrugët e kalldrëmta të lashtësisë së harruar/ bredhin turtujt e vjeshtës/ asnjë zog tjetër nuk banon këtu//. Me qindra vjet trokita në portat e mbyllura/ asgjë nuk pashë, as dëgjova/ përveç kollitjes së drynave//.

Cikli i tretë i vëllimit poetik "Kur mbërrijmë në fund të rrugës" pasqyron të tashmen, e cila nuk është vetëm një përsëritje e ciklit fatalist të njeriut dhe popullit fatkeq, që për shkak të rrethanave historike jeton më shumë në të shkuarën se në të ardhmen.

Një ditë si makthi zgjohet/ me buzëqeshjen e shfrenuar/ kurse ditën tjetër/ nuk i hapet asnjë portë në jetë//.

Në tërësi, vëllimi poetik “Pikëllimet e rrënjëve”, me të tri ciklet e tij, shpreh përpjekjet e suksesshme të autorit për të na zbuluar atë që nuk mund ta kapin shqisat e njeriut të zakonshëm. Në ciklin e parë kemi reflektim mbi kohën; në të dytin fatalitetin historik, në të tretin përpjekjet që mbeten pezull, se nuk japin atë që duhet.

Poezia e libri “Pikëllimet e rrënjëve” shpreh një reflektim kolektiv, të shprehur me një gjuhë metaforike dhe simbolike, që janë përdorur me mjeshtëri. Poeti kapërcen ndjesinë e përshtatjes, duke kaluar në një kohë tjetër, si një reflektim personal mbi fatin e vet. Ai është në kërkim të arsyes dhe kuptimit kundër moskuptimit, keqkuptimit dhe asgjësë. Është një botë shqetësimesh njerëzore identitare që në periudha pushtimesh, çekuilibresh shoqërore, apo dhe të integrimeve globale përbëjnë shqetësime për popujt e vegjël që janë në përpjekje për t’u imunizuar, mbrojtur dhe integruar, pa bjerrjen e thelbit të vet.

Poezia e poetit Adem Zaplluzha buron së brendshmi nga shpirti i poetit si një monolog, dialog dhe thirrje qytetare. Zaplluzha është mjeshtër i fjalës, poet origjinal i përjetimeve të holla, krijues i vargut të gdhendur dhe figurave të zgjedhura. Të gjitha poezitë e këtij vëllimi qëndrojnë bashkë për të deshifruar njëra tjetrën, si pjesë reflektimesh të bashkuara rreth shqetësimit njerëzor. Poeti Adem Zaplluzha është në kërkim të domethënies

ekzistenciale, që e shpreh me vargje, për në na kujtuar se fjala është çelësi për të ndriçuar horizontet trunore dhe labirintet shpirtërore të individëve.

Cikli i parë

Askund nuk ishte fundi

NJË KETËR I VETMUAR

Sonte jam vetëm
Mes fjalëve dhe këtij pylli
S'bëzajnë turtujt
Nën gjethet e rënduara nga pesha
E ajrit të mykur
S'dëgjohet as gjëma e pyllit

Një ketër i vetmuar
Si era kërcen prej një dege
Në degën tjetër të fjalëve
Përpos qetësisë së hukamës
Dëgjohen ankthet e rrënjëve të shkulura
Dëgjohen zëzëllima gjethesh

Kjo kohë vjeshte paska mbetur peng
Në pragun e kujtesës
Mbase është koha e një kohe
Kur ndërzehen macet
Monopateve të fëmijërisë
Dalin në shesh lejlekët e atdheut tim

PIKËLLIMET E RRËNJËVE

Përse kjo fjalë e ndrydhur
Çfarë të bëjë me skeletin e saj
Në zbrazëtinë e ajrit
Po mbytem si një bretkosë e verdhë
Çfarë të bëjë me pikëllimet e rrënjëve
Po më ngufasin deri në asgjësim

Shiu vrastar i mbrëmshëm
Nuk i ngjante më shiut
Dukej si përroi i çmendur
Sa pa mëshirë i theu ullukët
Sa që këndesi i metaltë
Asnjëherë më nuk e zgjoi mëngjesin

Shiu i cili i ngjante fjalëve të grisura
Rrinte si një buf
Mbi çatinë e shembur të kujtesës
Derisa hëna e çmendur
Në një gjysmë rrethi magjik
Vallëzonte me meteorët endacakë

Sa të trishtuara ishin lehjet e drurëve
Një skile e vjetër
Pabesisht kafshonte ashtin e tokës
Kafshonte dhembjen
E cila me vite po kullon gjak
Kullon si rrëshira trishtimi i një kohe

UNË JAM NISUR DERI ATJE

Nuk di se për ku jam nisur
Por unë do shkoj diku
Atje ku lejlekët e atdheut tim
I rindërtojnë çerdhet e shembura

Do takohem me disa lloje zogjsh
Në itineraret e tyre
Do i kërkoj fshehtësitë e të gjitha fluturimeve
Do njoftohem me frymëmarrjet e pemëve

Ju thashë se unë asgjë nuk di
Për të hyrë në fshehtësinë e gurit
Njeriu duhet të troket
Shtatë pashë thellë në zemrën e tokës

Rruga është e gjatë deri në atdhe
Detet janë të pa kapërcyeshëm
Unë jam nisur deri atje

Ku më presin fluturat e trëndafilta

Nuk ka rrugë që s'mund ta kapërcej njeriu
Vetëm se duhet të niset
Me të vetmen dashuri të pafundme
Për të mbërri deri në prehrin e atdheut

MBASE KANË ECUR EDHE PARA MEJE

Me ca grimca fjalësh nëpër xhepa
E mora dynjanë në sy
Dymijë vjet u sorollata ledheve
I kapërceva fushat e vdekura
Asnjë njeri nuk i përngjante
Fluturave të fëmijërisë

As unë nuk i përngjaja drurëve
Që flinin si kuajt e luftës duke ecur
Ishte një kohë e shthurur
Flamujt mbi shala të thyera
Këndonin një këngë të vjetër
Për shërimin e plagëve

Shumë njerëz ecnin pas meje
Nuk më kujtohet
Mbase kanë ecur edhe para meje
Po nuk është me rëndësi tani
Se kush ishte para e kush mbrapa
Ne gjithsesi kishim mbetur në një tjetër kohë

URIA M'I GRINTE RROPULLITË

Asgjë përpos kashelashave
Dhe një zarfi të dylltë
Nuk kishte mbetur në trastën time
Uria m'i grinte rropullitë
Kurse acari depërtonte në ashtin e tokës

Kujt t'i ankohem
Derisa kaloj mbi urën e thyer të kujtesës
Askush nuk më njeh në këtë qytet
As unë nuk njoh askënd këndej pari
Vetëm drurët i kam dëshmitarë

Me një flamur të ndrydhur
Dhe kalë të verbër bredhi rrugëve
Disa me quajnë patriot
E disa të tjerë dezertor
Kurse unë as vetë nuk di se kush jam

Në shikimet përbuzëse të njerëzve
Takoj siluetën time të kërrusur
Takoj tërë atë peshë të rëndë
Të cilën nuk mund ta bartë asnjë njeri
Derisa një flamur i grisur kalon në heshtje

ASKUND NUK I SHIHET FUNDI

Buzë rrugëve të dhunuara
Flenë drurët
Flenë si ushtarët dezertorë
Kalimtarët e rastit
Mbi shala kuajsh të trembur
Fle edhe vetë beteja

Kësaj dite të gjatë
Askund nuk i shihet fundi
Vetëm fillimi hingëllon si kali i tërbuar
Nga beteja dolën disa korba
Dhe fluturuan
Përtej ngrysjes së qiellit katran

Nën kavakët e shkundur
Po ashtu flenë kandrat e të gjitha llojeve
Dielli i thyer në horizont
Me nostalgji shikon të nesërmen
E cila nuk ka kurrfarë shansi
Të duket në qytetin tonë

TROKASIM NË DRITARET E DRYNAVE TË DYLLTË

Çfarë bëhet prej njeriut
Kur i vdesin fjalët
Një qiri që nuk ndizet
Nuk ka kuptim ta përdorim
As në varrimin e hijes

Fjalët herë zgjohen
E herë futen në djepin e nostalgjisë
Ngjan që nga një fjalë e vetme
Të shemben të gjitha urat
Që i ndërtuam me vite

Kur i humbim fjalët
Ose mbesim si koçan i mykur në bahçe
Dalim nga kujtesa dhe trokasim
Në të gjitha portat e hapura
Trokasim në dritaret e drynave të dylltë

KA KOHË QË NUK E PAMË DRITËN

Ky diell i baladave gjithmonë
Si dhëndri i gabuar
Hyri në shtëpinë tonë
Aq shumë shndrinte
E aq pak bënte dritë

Sa herë që i këndduam diellit homerian
I zgjuam të gjitha legjendat
U zgjuan edhe cirqet
Sa që në tokën tonë të shenjtë
Ka kohë që nuk e pamë dritën

TË THASHË MOS I MBYLL DRITARERT

Nëse sonte trokas
Ti mos i mbyll dyert e mendjes
Lëri të hapura dritaret e kujtesës
Mos harro
Sonte është nata e kërshëndellave
Kur dashurohen zogjtë prej argjile

Unë nuk erdha vjet
E di ti mirë se kush trokiti
Në xhamat e palara të kujtesës
Mbase trokitën erërat
Mjegullnajat posa ikën nëpër fusha
Te rrënjët e rrapit këndonte një laraskë

Të thashë mos i mbyll dritaret
Nëse i dëgjon të trokiturat
Hape mendjen
Bëri sytë katër si kokrrat e ullirit
Te pragu do pres si baba dimri
Është koha për t'i kyçur dritat e bredhit

S'DO TË KËNDOJNË MË

Në paça mundësi dhe forcë
Sonte nuk do të lejoj
Të këndoj qyqja mbi çatitë e lagjes
Aq shumë na ka dhunuar zëri i saj
Sa që s'mund ta largojmë nga mendja

Këndoi vjet një tjetër vjet
Njëqind pranvera i dëgjuam
Kukamat e saja të shthurura
Ju thashë s'do të lejoj më
Që asnjëherë të këndoj ky shpend kobzi

Më kujtohet kur ishte koha e qyqeve
Mbi çatitë e lagjes
Me ngashërim dëneste sterra
Ishin ato net ku për një fjalë goje
Të futnin pas grilave

Do kem mundësi dhe forcë
Të ua zë njëherë e përgjithmonë
Pritën qyqeve të zaza
S'do të këndojnë më
Mbi kulmet dhe kopshtet tona të dhunuara

DERISA TA VË NJË GUR NË ZEMËR

Do dalë një ditë nga lëkura ime
Do e marr dynjanë në sy
Do vë një gur të zi vari
Mbi çatinë e muranës ku qajnë qyqet

Do vë mbi zemrën time
Do vë sepse dua t'i mbylli
Të gjitha dritaret
Që hynë dhe dalin nga mendja ime

Sa herë që i shikoj yjet
Sytë më ngjiten majave
Shoh se si kuajt e egër

Vrapojnë pas meteorëve të shkundur

Do dalë një ditë e njëherë
Nga lëkura ime e rrudhur
Do eci udhëve të dynjasë
Derisa ta shkuli atë gur nga zemra

KUDO DËGJOHESHIN KËLTHITJE NËNASH

Ku ishe ti
Ku isha unë
E ku ishin ata
Të cilit fshehurazi kapërcyen
Mbi gardhin e shthurur të mendjes

Më kujtohen çastet
E rrokullisjes së gurëve
Një kryq prej druri
Si në ndonjë legjendë ecte pas të reshurave
Ecte në drejtim të yjeve

Ishte dita e kthjelltë
Mbase edhe dukej si një errësirë
E tunxhtë
Kudo dëgjoheshin këlthitje nënash
S'pushonin as britmat e fëmijëve

Një kryq i drurët
Mbështetej mbi trupin dhe shpirtin
E gjakut të njomë
Kurse nga gishtat e drobitur
Çurgonte vaji i pikëlluar i ditës

KJO PYETJE MBASE NUK KA FUND

Një herë moti pata dëgjuar
Kur thoshin se ka diçka tjetër
Përtej mendimit
E sotmja nuk ekziston
Por vetëm e nesërmja zvarritet
Si një zvarranik pa shpirt

Çfarë nuk flasin njerëzit
Nga gjuha e secilit pikon si pështyma
Një lloj pelini
Që e helmon ajrin e tendosur
Në telin e pestë të kitarës
Por vetëm flasin sa për të mos heshtur

Nëse nuk ekziston e sotmja
Si mund të jetoj e nesërmja
Kjo pyetje mbase nuk ka fund
Secila fjalë që thuhet
Mbështetet fort
Mbi shpatullat e lodhura të ajrit

Unë them se e nesërmja
Më shumë i ngjanë të sotmes
Se sa e sotmja një të nesërme tjetër

Çfarë s’dëgjova për fjalët përtej mendimit
Kurse e nesërmja
Rri varur për një çengel të trishtuar

Prishtinë, 7 tetor 2016

ME GJYSMË FLAMUJ DHE KUAJ TË NGORDHUR

Do të dalë sot në dritë
Do qëndroj ulur te pragu i dhembjes
Aty ku zunë fill mëkatet
Me një gazetë të vjetër në dorë
Do i përzë mizat e bezdisshme

Nga ky prag arkaik
I kam përcjellë me frikë ushtarët
E të gjitha kohërave
Më kujtohet vinin me muzikë
Kurse pas një kohe kalonin mbi lafet

Çfarë nuk pashë nga kjo perspektivë
Kur qëndroja ulur
Kaluan nëpër këtë udhë të madhe
Njerëz të besës dhe ata që e mbanin
Në gojë besën si gjuhën e gjarprit

Kaluan djaj e cerberë që i lënë pushkët
Peng në logun e mejdanit
Me gjysmë flamuj dhe kuaj të ngordhur
Pashë ikjen e ardhacakëve barbarë
Çfarë nuk pashë tjetër mbi plagët e atdheut

SE SA QË MUND T'I SHËROJMË

Më duket se po ripërsëriten ngjarjet
Historia e përdalë
Po i ngjan të djeshmes
Njerëz të njëjtë por me kapela tjera
Parakalojnë ledheve të saja

Pas ikjes së etërve zunë vend
Sërish bijtë e bijve të djajve
Po ata që dinë për mrekulli
Ta mbjellin Farën e keqe
Mbi shtatin e plagosur të atdheut

Deri kur do zgjas kjo dhembje vallë
S'durohen këto plagë
Më shumë po rihapen
Se sa që mund t'i shërojmë
Mallkimi i cilës kohë na zuri

Unë nuk mund të marr frymë dot
Me dhemb truri
Ndjenjat më janë dobësuar aq shumë
Sa që nuk ndjej kah më grimcohen thonjtë
Si kashta e vjetër po thyhen thinjat e flokëve

KUNDËRMON SI PLAGA E DJESHMES

Të gjitha ngjarjet e ditës së djeshme
I përjetova sot
Te pragu i derës çmendurish lozte era
Sërish ushtarë të shthurur
Parakaluan nëpër ëndrrën time

Desha të iki përtej çdo mundësie
Por s'pata se çfarë t'u bëjë
Hapave të rënda të historisë
Më duket se pashmangshëm
Ajo sot sërish do ripërsëritet

Nuk më lë rehat ky prag i vjetër
Orë e çast më ngacmon
S'mund të qëndroj në këmbë
Ama nuk më len as të ulem
Si të pushoj pakëz nga kjo kronikë e zezë

Sa herë e mbushi pagurin në çezme
Pa e pi gllënjkën e parë
Aq shumë turbullohet uji
Sa që kundërmon me dhembjen e betejës
Kundërmon si plaga e djeshmes

TI SHTATË HERË ISHE MË I FORTË

Trungun me shtatë plagë atdhe
Shtatë herë të shituan zanat
Gjëmim malesh në shpirt
Rropullitë ngjajnë
Me iluzionet e plagëve shqiptare

Dua sonte që ta harroj vetveten
Kjo dhembje e pasosur
Po i përshtatet plagëve tua
Moj tokë e bekuar e etërve të mi
Tokë asnjëherë e gëzuar

Ishe dikur diçka më shumë
Se shpirti i pathyeshëm i pallës
Murrlan që i shembi
Të gjitha stuhitë e mundshme
Dhe ato të pamundshme

Sa herë që t'u afrua zjarri
Ti shtatë herë ishe më i fortë
Në hi e pluhur
E shndërrove gjuhën e zjarrit
Atdheu im pavdekshëm

TË ZGJOHEN LISAT

Ka qenë dashtë shumë më herët
Të hapet ky kapitull
Mbase as sot nuk është vonë
Zogjtë gjithmonë fluturojnë
Në drejtim të dritës

I kaluam ato kohëra që hanin gurë
Prej një kokërre pluhuri e zgjuam atdheun
I cili kurrë më
Nuk e pat gjumin e rehatshëm
Nga balta e kësaj toke gatoi njeriun

Gatoi bukën e përditshmërisë
Në shpirtin e fushës së mëllenjave
Që një ditë
Të zgjohen lisat e gjatë
Të qohen peshë malet në këmbë

Ka qenë dashtë shumë më herët
T'i zgjojmë nga përgjumja rrapet
Mos t'i lëmë as perënditë të flenë
Si patën fjetur ëndrrat
Atdheu kërkon dinjitet dhe flijim

STATUJAT

Statujat si drurët s'marrin frymë
Jetojnë mes njerëzve
Në një zhgjëndërr të hidhur
Dje ishin njerëz
Si të gjithë njerëzit me ëndrra
Kurse sot u ngjajnë hyjnive të bronztë

Statujat e qytetit tim
Nëpër xhepat e tyre bartin
Bartin peshën e një kohe
E cila s'kthehet më
Kur era ua laton kujtimet
Ato jetojnë në Olimpin e perëndive

Jo jo statujat në këtë qytet
Marrin frymë
Jetojnë më mirë se çdo kush
Nuk u ngjajnë njerëzve
Jetojnë pa maska ballëhapur
Jetojnë perëndit e mermerta të qytetit tim

NGA LLAÇI GATUHET DITA

Nëpër skuta rrugësh maska
Dhe fytyra të grisura
Kjo është e tëra
Çfarë mund të shohësh në këtë qytet

Një flutur krah djegur
Mbi një tavolinë të thyer në tavernë
I mbledh me kujdesin të madh
Kujtimet e së kaluarës

Nëpër trotuaret e papastra
Ndërzime macesh
Njerëz me nga një unazë në hundë
Ngjajnë me qentë endacakë

Bredhin poshtë e lart
Nëpër gjeografinë e shpirtit
I hulumtojnë çastet e jetës

Që kurrë nuk i përjetuan

Në qoshe pranë furrës “Bjeshka”
Nga lloçi gatuhet dita
Gatuhet koha e një kohe të trishtuar
Kur për një kafshatë njeriu ndërron fe

RRËSHQITJE GOMASH NËPËR SHI

Mbrëmë i dëgjuam si në ëndërr
I dëgjuam krismat e shurdhëta
Të një nate
Më pastaj rra heshtja e metaltë

Pakëz më vonë u dëgjuan zhurmët
E një sirene
Rrëshqitje gomash mbi asfalt
Sterra e zezë mbuloi qytetin

Zhurma dhe asnjë zë tjetër
U dëgjua vetëm zëzëllima e një mize
Dhe sërish errësirën prej bloze

E mbuloi heshtja

Krismë pushkësh
Dhe rrëshqitje gomash
Zunë vendin meritor atë natë
Në ditarin e një kronisti

NËPËR FALTORET E BOSHATISURA

Ku të rri sonte
Në kujtesën e kujt të zë pak vend
Mbi kokë dëgjoj lehje yjesh
Kurse nën tokë
Si ujqërit ulërinë bubullimat

Një amalgamë yjesh
Bredhin hapësirës së plagosur
Shrapnela zjarresh derdhen
Kalldrëmeve arkaike
Derdhen pas hapave në ikje

Nëpër rrugë të boshatisura
Grumbuj të paparë deri më sot
Bredhin macet me mjaullimat
E pazakonshme
Mbase edhe era sonte mjaullin

Nuk paska asnjë udhë
Përtej kësaj rruge
Era e barotit kundërmon qosheve
Nëpër faltoret e boshatisura
Fshihen mushkonjat aziatike

Cikli i dytë

Përveç kollitjes së drynave

PËRPOS IKJES NGA VETVETJA

Ikjeve nuk u dihen
Asnjëherë drejtimet
Kah do që të ikën njeriu
Gjithmonë e merr me vete vetveten

Me një valixhe të vjetër
Mbushur me zogj të plagosur
Largohet nga pragu i shtëpisë
Por gjithsesi kujtimet shkojnë pas tij

Ju thashë dhe sërish po ju them
Se nuk mund të iket
Askund nga vetvetja
Janë të tmerrshme ikjet e këtij lloji

E tërë e kaluara
Sido që të jetë ajo hallkë zinxhirësh
Lidhet tmerrësisht lidhet

Për fijen e fatin e ikjes

Ditën kur kthehesh në atdhe
Më beso o njeri i mirë
Asgjë nuk do të të kujtohet
Përpos ikjes dhe vetvetes së zhgënjyer

DEGËT E THYERA TË KAJSISHTAVE

I lashë dy hapa pas vetes
Asnjë pëllëmbë para meje
Si të eci në këtë sterrë
Kah më çojnë këto udhë

Një matematikë e thjeshtë
Me shumë numra të panjohura
Shikoj përpara
Hapësira noton deri në askund

Që ta pyes për një adresë
E cila nuk ekziston
Asnjë njeri nuk banon
Në katin e shtatë të qiellit

Erdha deri te kjo pikë
Shikoj mbrapa shoh zbrazëtirë
Kurse përpara syve të mi

Si një pendël noton arkivoli i ditës

Asnjë flutur nuk shoh
Mbi degët e thyera të kajsishtave
Gjethet e fishkura si krih të djegur zogjsh
Pandërprerë bien mbi gjoksin e vjeshtës

PËRVEÇ KOLLITJES SË DRYNAVE

Shikoj horizontin skizofren
Si një balon i fryrë noton hëna
Asnjë yll tjetër
Nuk duket në hapësirën e pafundme

Nata dhe qielli i portokalltë
Një tablo surrealiste
Qenka varur për bishtin
E një meteori endacak

Nëpër rrugët e kalldrëmta
Të lashtësisë së harruar
Bredhin turtujt e vjeshtës

Zogjtë më nuk banojnë këtu

Me qindra vjet trokita
Në portat e mbyllura
Përveç kollitjes së drynave
Asgjë s'pashë as nuk dëgjova këtu

NGA TË KATËR ANËT E FJALËVE

Thonë se i urti
Me një urtësi të padëgjuar
Mund të qëndroj në bregun e kundërt
Te mendjes
Mund të qëndroj dhe të bisedoj me urtësi
Me peshkun e ngordhur

I tërë deti habitet
Si mund të bisedoj njeriu
Me skeletin e peshkut të mykur
Era monotone frynë
Nga të katër anët e fjalëve
Njeriu zgjohet nga ëndrra e ujit

Çfarë nuk përjetuam kur i pamë
Përmbytjet e anijeve të shurdhëta
Një varkë doli nga fundi i detit
Dhe mbeti e stepur si sirena e dashuruar
Kur e pa njeriun e urtë
Dhe peshkun e artë mes një monologu

TROKASIN STËRKALAT E LAZDRUARA

Nuk di a mund të kuptojnë njerëzit
Si unë zërin e mrekullisë së shiut
Kur muzika hyjnore
Në ato çaste
Buron nga thellësia e qiellit

Sa herë që shikoj shiun
Shoh se si zbresin në tokë
Stërkalat lakuriqe
Zbresin me një madhështi
Që ma përkujtojnë liqenin e mjellmave

E pikëzat imcake të shiu
Për çdo ditë trokasin te xhamat e kujtesës
Trokasin stërkalat e lazdruara
Nëpër mendjen time
Sa me nostalgji trokasin në portat e të dielave

TË PAVDEKSHMIT E DIKURSHËM

Njerëzit që dikur besonin
Se janë të paprekshëm
Sot janë plakur
Ecin si lisat
Ecin të kërrusur deri në tokë

Lëvizin ngjashëm me dinozaurët
Shpeshherë ngjan
Që bastuni të ecën para tyre
Për një kafe të mëngjesit
Nga shtëpia dalin pa kapelë

Sa herë që ulen të pushojnë
Në ndonjë stol të vetmuar
Ju kujtohet rinia
Dhe puthjet e vjedhura
Nën hijet e kujtimeve të ikura

Sot kalojnë në heshtje mortore

Nëpër rrugët e qytetit
Të pavdekshmit e dikurshëm
Në secilin hap
I numërojnë mëkatet e së kaluarës

Prishtinë, 8 tetor 2016

NJË PEMË ME FYTYRË TË ZHUBROSUR

Do të dalë
Do dalë një ditë nga lëkura ime
S'durohet më kjo gjendje
Secili njeri
Duhet t'i përkulet kryqit vet

Një ditë shohë dru lakuriq
Kurse tjetrën ditë
Si nga një përrallë e lashtë
Zgjohen makthet
Na ngufasin përfundimisht

Zgjohen edhe lukunitë
Që asnjëherë nuk i zuri gjumi
Një pemë me fytyrë të zhubrosur
Me mija vjet qëndron në heshtje
Dhe i numëron mëkatet tona

Më thoni pra përse të mos dalë
Nga kjo lëkurë e grisur
E cila nuk po e duron
As frymëmarrjen time
Një ditë do të dalë nga lëkura e ime

NËPËR BAHÇET E DJEGURA

Për çdo ditë ulem
Pa kurrfarë kontrolli ulem
Të bisedoj me pragun e kujtesës
Fëmijëria e zbathur
Paraqitet si një vegim i së kaluarës

Lulet në kopsht sivjet nuk çelën
S'çelën as vitin e shkuar
Një britmë e pakontrolluar
Zgjoi lagjen nga gjumi
Asnjë këndes i metaltë nuk këndonte

Kaluan edhe disa mote të vështira
Dëgjuam hingëllima mjegullash
S'ndaleshin as palljet
E lopëve të sëmura
Një sëmundje e rëndë bredhte skutave

I ftuam astrologët e të gjitha kohërave
Asnjëri asgjë nuk tha
Thua se ishin të nemitur gurtë
Nëpër bahçet e djegura
Një tym i pa definuar kishte ngritur kokë

MBËSHTETËN NJË ARKIVOL TË GURTË

Me sy të përlotur shikonte
Shollat e këpucëve të grisura
Ishte e diel
Ditë feste kur kremtonin
Ikjen ose ardhjen e një zëri të shurdhtë

I tërë fshati qëndronte
Nën degët e rrapit qindvjeçar
Nuk dinim se kush e bëri këtë
Por dikush ia vuri zjarri që me mija vjet
Po digjet nën këtë dru të pavdekshëm

Ju thashë se drutë nuk vdesin asnjëherë
Në fshatin tonë
Kjo mund tu ngjajë njerëzve
Por drurëve
Ende askush nuk ua ka dëgjuar gjëmën

Mbrëmë erdhën dy të huaj
Erdhën tinëzisht
Mbështetën një arkivol të gurtë
Mbi shpatullat e mjegullave
Mbështetën dhe ikën ashtu siç erdhën

AJO ME ATO NËNA MALESH

Tek po zbres nga froni i mjegullave
Ajo i qëndiste tregimet e saja
Në fund të monopatit
Këndonte kumria
Elegjinë e papërfunduar të gjelbërimit

I tërë mali merret frymë si njeriu
Gjethet zbritnin nga degët
Zbritnin
Me një elegancë të padëgjuar
Te rrënjët e kujtimeve ajo endte pëlhurën

Ishte dita e shtatë e krijimit të botës
Të tetën ditë
Përjetova harlisjen e lumenjve
Malet u quan në këmbë
Dhe për çudi lindi një botë e re

Ajo me ato nëna malesh
Këndonte tok me zanat e mira të Alpeve
Këndonte këngën e saj të preferuar
Ishte kënga e lindjes
Se një kënge që do këndohej me shekuj

TANI MË ËSHTË TEPËR VONË

Tani më është tepër vonë
Kur kuptova
Se përse të zbritën nga kali i egër
Të zbritën sepse s'ishin në gjendje
Ta frenojnë të nesërmen
I cila herët e nisi galopin

Të patëm lutur si hyjin
Të thamë se je gjaku i jonë
Nga damarët e tokës
Po mbinë legjendat
Por tani është tepër vonë
Ta zëmë kohën që iku mes gishtave

U largove tej përtej maleve
U zbehën edhe hijet
Tani më është tepër vonë
Për ardhjen e stinëve të tjera
Një zog vajtues qante në maje të plepit
E atdheu s'është në gjendje t'i shëroj plagët

NJË ZË I LARGËT VINTE NGA HOJET

Nuk di dhe kurrë nuk kuptova
Se si i bashkuam duart
Me shiun
Dhe zërin e kambanës
Por ne gjithsesi i bashkuam

Bari atë ditë kishte një tjetër ngjyrë
Dukej si i portokalltë
Ose gjelbërimi
Nga shkundja e rrënjëve
Humbi formën e pamjes paraprake

Ndoshta te gjethet flinin krimbat
Flinin edhe rrënjët
Një zë i largët vinte nga hojet
Nën pemët e dhunuara
Trishtoheshin dashnorët dezertorë

DISA LLOJE PËRMENDORESH

Një lumë i trazuar
Për çdo ditë kapërcen nëpër lagjen time
Kapërcen me mendime të shthurur
Pranë Urës së Gurit
Dëgjohen lehjet e pandërprera

Këtu lehin edhe meteorët
Gurtë e murrmë
Duken si statuja të verdha
Nën këmbët e lakuara të urës
Kurrsesi s'pushon kori i kërmijve

Sa e sa herë kalova këndej pari
Nuk më kujtohen emrat e përmendoreve
Por si hu gardhi ishin ngulitur në tokë
Disa lloje metalesh me ngjyrë
Duke ja lënduar shpirtin e qytetit

Sa herë që ky qytet qante
Cijatnin edhe përmendoret
Një dënesje malli për të kaluarën
Lehte pandërprerë
Tok me qentë endacakë të qytetit tim

DETI I URITUR

Qenkan zënë të gjitha vendet
S'ka më ku të ulen zogjtë
Nën pemët e dhunuara
Pandërprerë dëgjohen britma njerëzish

Dimri ishte këtu mbase zuri vend
Mbi kurorat e sëmura të pemëve
Kallkanët shumoheshin si bari
Kurse te pemët ngjau e kundërta

Asnjë kronist nuk i shënoi me numra
Nëpër defter dëbimet e njerëzve
Thonë se nga anija "Turan"

Nënat i gjuanin foshnjat në det

I gjuanin të mos vdesin urie
Deti i uritur
Si një bishë e paparë
Kafshonte mishin e njomë të një populli

PROTESTOJ PËR HESHTJEN NJERËZORE

Nuk dua të kaloj këndej pari
Po më pengojnë ngjyrat e verdha
Qenkan shkundur mbi shpirtin e tokës
Të gjitha gjethet e vjeshtës
Thua se era i dogji pemët në rrënjë

Një ditë ndoshta që nesër
Do të trokas në ndërgjegjen njerëzore
Nuk dua që t'i shkundin pemët
Ky kopsht i trishtuar i njerëzimit
Me qindra vite po lëngon

Ju lutem mos mi ngacmoni ëndrrat
Pak si shumë jam lodhur
Ky udhëtim i gjatë
S'paska të sosur
Kurse mua më ka dërmuar pleqëria

Çfarëdo që të ndodhi
Unë s'do të ndalem së protestuari
Protestoj për shkundjen e pemëve
Për gjuhën e mbjellë të urrejtjes
Protestoj për heshtjen njerëzore

KOT E DËGJUAM ZËRIN E SHIUT

Përbrenda kësaj poezie
Shoh se kjo botë në miniaturë
Kolovitet ledheve
Kolovitet si miza e bezdisshme
Jashtë dhomës sime
Shemben muret e së mundshmes

Ti si një hije bredh nën plepat
E kalbura të vetëdijes
I kërkon duart dhe zërin tënd
Nën qemerët e ndonjë ure të shembur
E kërkon
Fëmijërinë nëpër bankina

Kot e dëgjuam zërin e shiut
Era e mbyti këndesin e metaltë
Kurse pemët e rënduara nga dhembja
Kurrë nuk u këndellën
Për të mbërri
Deri te trishtimi i golgotës

MË KUJTOHET KUR ISHIM TË HUMBUR

Kur bie mbrëmja
Nuk di a mund të ngritët në këmbë dita
Dy zogj të lagur në shi
Me nostalgji shikojnë çerdhen e vjetër

Zëri i mjegullave duket i shurdhët
S'dëgjohen piskamat e pemëve
Nën plepat e nakatosur

Gabimisht u takuam me vetveten

Më kujtohet kur ishim të humbur
Loja e jonë nuk na përkite neve
U ngjanim zogjve klandestin
Sa herë kishim etje i ndërronim çerdhet

ERA NGADALË DEPËRTON

Në mëhallën tonë të shkrumit
Si nga ndonjë tinarë i vjetër
Dëgjohet zëri metaltë i erës
Këndon pa i njohur notat
Në pentagramin e grisur dënes një melodi

Nën selvitë e djegura për herë të tretë
Vallëzojnë milingonat e kuqe
Era ngadalë depërton
Depërton si një hije morbide
Në qenien e dyshimtë të ndërgjegjes

NUK NA KISHTE MBETUR ASNJË FJALË

Si zogjtë e fëmijërisë
Era vallëzon në pluhur
Nën kavakët e lagjes
Dëgjohet një muzikë arkaike

Askurrë nuk trokita përtej mase
Por dyert gjithmonë
Hapeshin si fjalët
Mbrëmë etja i ngjante dashurisë

Sa më shumë pimë ujë nga çezma
Aq më tepër më mundonte etja
Një shtambë zbriti nga kujtesa
Kur përroi u derdh në lumin e fjalëve

Ne u stepëm
Nuk na mbeti asgjë se çfarë të themi
Vetëm duart na lëviznin në ajër
Lëviznin si krahët e djegura të fluturave

Prishtinë, 10 tetor 2016

AQ SHUMË E NDIQTE HIJA E TIJ

Nuk është e vërtet
Se njerëzit si reliktet e rralla
Mund t'i fshehin gjërat
Asgjë ama asnjë fije floku
S'mund të fshehim prej pasqyrës

Si një flluskë sapuni mund të zhdukemi
Të mos ekzistojmë
Mund të shndërrohemi edhe në pluhur
Por hapat tona
Na përcjellin edhe në udhëtimin e fundit

Njëherë një mik i im i fëmijërisë
Deshi të ikte prej vetvetes
Por kurrë nuk i priu fati
Aq shumë e ndiqte hija e tij
Sa që e ndoqi edhe përtej varrit

XHAMBAZËT E KËNAQUR I FËRKOJNË DUART

Një kohë të gjatë pritëm ardhjen e trenit
Aq shumë pritëm
Sa që u kalbën traversat horizontale
Ora e murit u ndalë
Zembereku i ndryshkur cijaste
Thua se dikush ja ndukte pendlat

Nëpër muret e stacionit
Ishin ngjitur afishet e të gjitha luftërave
Partitë politike
Si bishat kafshonin njëra - tjetrën
Vetëm dhelprat qëndronin anash
Pritnin t'i ngulin dhëmbët në mishin e njeriut

Nën pemët e shkundura dielli i përskuqur
Piqte pluhurin e shkapërderdhur të rrugëve
Piqeshin edhe librat e vjetër
Çdo gjë në këtë qytet ka dalë në shitje
Shiten protezat e të gjitha llojeve
Xhambazët e kënaqur i fërkojnë duart

NGJAN NJË PJATE PORCELANI

Dhe më në fund si perënditë
Bie një natë
Errësira e tunxhtë
I shtrin krahët te ullishtat
Hëna gjysmë e thyer
Ngjan një pjate porcelani

Asgjë e jashtëzakonshme
Nuk ndodhi në teatrin e qytetit
Vetëm se degët e kajsive
Disi u përkulën deri në tokë
Dheu i lodhur
Si i sëmuri nga tuberkulozi merrte frymë

Dhe ja ngjau ajo
Që duhej të ndodhte kaherë
Një kaproll i egër
Iku nga korijet e fshatit
Iku dhe kurrë më
Nuk i kthye me i marr brirët

Që moti jemi mësuar
Me rënien e netëve të thikave
Ikte një ushtri e huaj
Duke ja lëshuar vendin tjetrës
Kështu binin netët ballkanike
Binin si kumbullat e kalbura në tokë

PASKAN IKUR PATAT E EGRA

Qetë e lodhur dremisin në parmendë
Vija e hollë e sinorit
Pak më tutje
Një copë mjegulle me draprin e kujtesës
I korrte mendimet e luadheve

E tërë fusha e përgjumur
I përkonte zgërlaqet e palara
Një dorë e fortë
Qëndronte pezull si shpata e legjendës
Era me nostalgji frynte mes lisave

Shikoj përreth misërishtes
Asnjë njeri nuk duket në horizont
Paskan ikur edhe patat e egra
Vetëm një lejlek kokëfortë
Krenarisht pushonte në maje të oxhakut

MENDIMET DHE DYERT

Tani më mendimet po u ngjajnë dyerve
Sa herë që troket dikush
Instinktivisht hapen
Por edhe nuk mbyllen në të njëjtën mënyrë

Dyert dhe mendimet trokasin
Dhe gjithmonë trokitën
Herë vijnë miqtë
E herë armiqtë që s'dinë të ndalen

Një vijë e hollë në horizont
Pas saj udhët e tjera të pandalshme
Herë kapërcehen me lehtësi

E herë përjetojnë përmbytjet mendore

Një udhë e shumë punë thotë populli
Por mendimet dhe dyert
Gjithmonë i përjetojnë të trokiturat
Një hënë shtatzënë sonte i mëkon yjet

I THYEN DRITAT E NEONIT

Qetësi e llahtarshme
S'lëvizin as karriget prej plastike
Shigjetat e neonit
Gjuajnë me pështyma dritash

Herë hapen e herë lëshohen perdet
Në fund të sallës
Dëgjoj
Një britmë hamletjane

Dhe sërish një heshtje relative
Zëri kumbues i Otellos
I thyen dritat e neonit
Lagështit e mureve dënesin

Si në mortore vazhdon qetësia
Në rreshtat e para
Papritmas

Dëgjohen vajet e fëmijëve të posa lindur

Në sallë herë lëshohen
E herë ngritën perdet
Teatri si mjeshtri i pantomimës
Imiton tërë luksin e qytetit

Pas heshtjes befasisht në sallë
Fluturuan disa zogj qiellor
Dhe në kapelën me lule
Të një zonje të rëndë
I lëshuan disa vezë infektive

U NGRITËN SI PERËNDITË

Ishte natë dimri
Ishin të mbyllura të gjitha portat
Vetëm ato të urisë
Pranë dritareve
Qëndronin të hapura krah më krah

Mbase nga ndonjë legjendë
E lashtë
Na shikonin etërit
Kurse ne dy gjunjë rinim kruspull
Uria i ngjante bijës së çmendurës

Shikonim gurin në verigë
I nxirë katran
Kurse neve na dukej
Si një copë shprese e bukës së ngrohtë
Por çerepi ishte i boshatisur

Nëna dhe babai përtypnin trishtimin
Nuk kishin se çfarë të na ofrojnë
U ngritën ngadalë në këmbë
U ngritën si perënditë
Dhe na i dhënë kokrrat e farës së pambjellë

2.

Pas përtypjes kumbuan rropullitë
U dëgjuan grithje zorrësh
Të nesërmen fqinjët ardhacakë
Na sjellën dy thasë tërshërë
Deshën ta këmbejnë me flamurin e grisur

Aq shumë u hidhërua im atë
Sa që më duket se
Nga sytë e tij të vegjël
Shkrepën zjarret e gjithë dynjasë
Shkrepën dhe ua dogjën dheun nën këmbë

JETA VLEN DY KOKRRA MISËR

Sa herë më shkonin sytë
Kah koshi i zbrazët
Im atë ndjesë pastë thoshte
Jeta vlen dy kokrra misër

Dikur më vonë kur u rrita
Më kujtohen fjalët
Me të vërtetë kishte të drejtë
Dy kokrra misër vlente jeta

Ishin kohërat e liga
Vitet pesëdhjeta të shekullit të kaluar
Vitet e të kuqve që hanin njerëz

Me të vërtetë dy kokrra misër vlente jeta

Andaj misri ishte sinonim buke
Ishte flamuri i varfërisë
Që valëvitej mbi kokat tona
Valëvitej tok me vdekjen për dy kokrra misër

SHIU DHE NJERIU DY MIQ TË VJETËR

Me dorën e djathtë e mbante kapelën
Më duket se frikohej shumë
Mos t'i ikte nga koka
Çdo herë thoshte se kjo kapelë
Dinte edhe të këndoj

E mbante edhe me dorën e majtë
Kur i lodhej bastuni
Por gjithsesi kishte zakon
Si për kokën e vet të kujdesej
Për kapelën e grisur dhe bastunin

Sa herë që binte shi
Me një qese plastike e mbështjellë kokën
Del në oborr dhe vallëzon me pikat e shiut
Një valle të bukur arkaike
Vallëzon derisa të ndalen pikat e fundit

Shiu dhe njeriu dy miq të vjetër

Mes tyre kapela
Lozin lojën e stërkalave
Kurse kori madhështor i bretkosave
S’pushonte së kënduari deri në vjeshtë

Prishtinë, 11 tetor 2016

Cikli i tretë

Kur mbërrimë në fund të rrugës

KURSE NËN HAPAT E TUA

Është tepër vonë të flasim sonte
Të themi diçka për kotësinë
Ose zbrazëtirën e etjes
Kur unë nëpër dhomë i mbledh
Dromcat e fjalëve të thëna
Ti shndërrohesh në diçka që kurrë nuk ishe

Ishte vjeshtë e cila s'na la asnjë kujtim
Për të cilin mund të flasim
Heshtja zgjati aq shumë
Sa që sot papritmas
Shpërtheu si krater vullkani
Dhe ra mbi muret e kujtesës

Zgjati duart preke dhembjen e mashtrimit
Në ajrin e acartë të mëngjesit
Fluturojnë mendimet e shthurura
Kurse nën hapat e tua
Si në ndonjë gjol të pafund
Përjeton ringjalljen e kujtesës

SËRISH JEMI NË VJESHTË

Tani më nuk di
Për kë mund të shkruaj sonte
Një varg i vdekur
Mbase nuk mund të lind dy herë

Sërish jemi në vjeshtë
Kur vilen frytet e pjekura
Dhe ato të tjera
Që këputen nga degët e thyera

Vjeshta në kopsht dimri në dhomë
Mbi tavolinën e punës
Më presin në pritë

Fjalët që kurrë nuk i thashë

Më duhet të ua gjej fillin
Ose t'i varrosi përgjithmonë
Në flakën e verdhë
E cila pandërprerë ndizet në ajër

I NDEZA ZJARRET E MËDHA TË DYNJASË

Mbrëmë papritmas nga mendja fluturuan
Fluturat me krah të djegura
Nuk mbeti asnjë fërkim mbi tavolinë
Në gjysmerrësirën e fjalëve
Një qiri i ndezur qëndronte pezull

Asgjë s'të thashë as ti nuk fole
Ndoshta heshtja foli më shumë
Se sa mendojmë ne
Një fije e ndezur prej flake ndriçoi
Ditën e vdekjes së fjalëve

Gjithmonë kam pohuar
Se ishim pagan
Atë ditë perëndive ua ktheva shpinën
Që të mos ngrihen yjet
I ndeza zjarret e mëdha të dynjasë

Të kujtohet ishte stina e verës
Nga brinjët e mi kallkan
I shkula egërsitë e dimrave
Mes pemëve e shkula të kaluarën time
Desha të bëhem qiri në rrugën tënde

KUR TË MBËRRIN NË FUND TË RRUGËS

Edhe unë dikur isha njëri prej atyre
Që pata besuar
Se vdekja nuk është asgjë tjetër
Përpos një lindje e binjakëzuar me jetën

Gjithmonë dhe kudo janë bashkë
Vlen ajo deklaratë e kurorëzimit
"Në të mirë dhe në të keq"
Deri në fund e bartin njëra tjetrën

Gjatë tërë jetës nuk ka tradhti
Në çastin kur përfundon episodi
E njërës automatikisht në këtë vazhdimësi

Fillon repriza e pandalshme e tjetrës

Jeta dhe vdekja si dy mikesha
Kalërojnë njëra - tjetrën
Kur të mbërrin në fund të rrugës
I prekin krizantemat e kristalta

DYMIJË VJET JAM NË KËTË VARR

Mjaft më moj qyqe e shkretë
Mbi dymijë vjet këndove
Mbi varrin tim
Ku isha shtrirë
As i gjallë e as i vdekur

Mej njëherë moj zog shpirtzi
Mej he të shitofshin zanat
Përtej varrit
S'pata tjetër se ku të shkoj
I cili i ngjante atdheut tim

Varri i zi nën dhe
E varr i vithisur mbi tokë
Kurse ti moj e mjera
Këndon e s'ndalesh dot
Hesht moj qyqe të vraftë i madhi Zot

Nga kush mësove këtë këngë vaji
Ndalu pakës moj e shkretë
Dymijë vjet jam në këtë varr
Ku lindëm dhe vdiqëm
Por gjithsesi gjithmonë ishim krenarë

SECILI PLUMB NGJANTE ME VDEKJEN

Dashurinë dhe luftën e kaluam së bashku
Tangon e fundit
Vallëzuam nën breshrin e plumbave

ditë e diel
Më kujtohet
O fare mirë më kujtohet
Se si atë ditë
Me ngashërim qante kambana

Për çudi secili plumb
Ngjante me vdekjen
Herë dukej si kufomë
E herë ngjante me dhembjen e atdheut

Fytyra e murrme e frikës
Dukej sikur një maskë
E trishtuar e varrit
Kur pushuan krismat

Sa me mallëngjim dëneste lumi

Pakës më vonë
Papandehur dëgjuam kambanën
Kush mund ta ndalë në këto çaste
Vajin e trishtuar të kambanores

2.

Një zog i shenjtë atë ditë
Me qumështin e zanave
Mbështetur për murin e shembur
I mëkonte të gjallët e vdekur

Asnjë njeri nuk kishte forcë
Të qante atë menatë
Ecnin ngadalë
Si përmendore të mermerta

Me shikime të mpita
Deri në shtangie ecnin
Rrugicave të plagosura të qytetit
Kavakët përcjellin procesionin
E ushtarëve dezertorë

KJO HALLKË E VAZHDIMËSISË

Me një ritëm të njëtrajtshëm thahen
Por edhe çelin pemët
Sa fillon njëra stinë
Sa ora vjen tjetra me të reshurat

Kështu që njerëzit pemët
Dhe lulet
Ende pa çelur sytha të mirëfillta
Zëvendësohen me ato të reja

Kjo hallkë e vazhdimësisë
Në çdo stinë pashmangshëm përsëritet
Si një lojë e përkryer e natyrës

Ajo e humb ngjyrën por jo edhe formën

Mbeten ashtu siç ishin në fillim
Të virgjëra si nga dora e nënës natyrë
Siç di të krijoj vetëm ajo
Njomësinë e gjelbër të kokrrave të klorofilit

ME NJË LIBËR TË VJETËR

Në xhepin e pasmë në hinoren arkaike
Ai njeri e mbante hirin e vet
E mbante edhe bastunin
Si një gogol fushe
Kalonte rrugicave të ngushta

Ne nuk e njihnim atë njeri
Por edhe ai s'na njihte
Ishte i huaj
Siç ishim ne për të
Por gjithsesi në të parë na mashtroi

Thonë se endet këndej pari
Me një mision sekret
Kurse neve na dukej qesharak
Me çallmën dhe shallvaret gri
Që i mbështilleshin për këmbët rakitike

I njihte të gjitha rrugët dhe rrugicat
S'kishte lënë derë pa trokitur
Me një libër të vjetër
Dhe bastun të ri
Trokite nëpër mendjet e njerëzve

ACARI KAFSHONTE SI GJARPRI

Ai i mbylli sytë
Me një lahutë e tij të verbër zuri të këndoj
Një këngë të lashtë homerike
Donte t'u ngjante rapsodëve
Deri në alivanosje nuk ndaëej

Nuk di athua ishte vjeshtë ose dimër
Acari kafshonte si gjarpri
Kënga nuk ndalej
Këndonin edhe pemët
Me eufori dëgjohej zëri i një mjaullime

Me qindra njerëz shëtisnin rrugëve
Një stuhi i mbushte trastat me mjegull
Tej lumit të çmendur
Katër urat e qytetit
Përjetuan lulëzimin e pemëve në vjeshtë

E tërë kjo ngjarje mund të jetë edhe e sotme
Nga kali i dikurshëm Trojan
Çmendurisht po ikin buburrecat
S'kanë më me çfarë të ushqehen
Këmishët dhe pantallonat i hëngri mola

SHIU DHE URAT E THYERA

Shikonte syprinën e pafundme
Varkat i kishte hëngër tenja
Një sirenë e vetmuar
Mbi një kep të dhembjes
I shëronte plagët e kujtesës

Ajo e endte pëlhurën e mëndafshtë
Merimanga imitonte me mjeshtri
Kurthin e ditës
Kalorësit atë ditë të mjegullt
U ngjanin atyre të apokalipsit

Sa shumë ra shi sa që u rritën lumenjtë
Asnjë urë nuk mbeti pa u thyer
Si do të kalojmë në anën tjetër
Kur lukunitë e zeza
Na i vodhën edhe patericat

Shiu dhe urat e thyera
Në një kohë të thyer të mendjes
Apokalipsi sërish po zgjohet
Kuajve të zjarrtë
Po ua mbathin potkonjtë e urrejtjes

MBËSHTOLLA KOKËN ME NJË SHAMI

E nesërmja na dukej një zbrazëti
Si një nocion i largët
Ndoshta ajo as që ekziston
Në gjeografin e kujtesës
Çfarë të bëjmë me të sotmen
Pasi që kaq trishtueshëm po lëngon koha

Njëherë pyeta një të huaj
Për një adresë në qytetin tim
Drurët dhe kuajt
Me muaj të tërë nuk e ndalën qeshjen
Edhe dita kishte një qeshje histerike
Sa që u shkundën pemët në kopsht

Me të dy shpatullat e lodhura
Iu mbështeta ajrit

Mbështolla kokën me një shami
S'desha të dëgjoj më asnjë fjalë
Për të nesërmen
Duke ditur se ajo nuk ekziston

Prishtinë, 12 tetor 2016

NJERËZIT U LARGUAN SI TË STEPUR

Këtu paska rënë mbrëmja
Asnjë zog nate nuk këndon
Mbi çatitë me këndesa të metalta
Dëgjohen lehjet lukunive

Diku në fund ose në fillim
Të rrugës
S'pushojnë mjaullimat e yjeve
Një zë alegorikë zbret nga sterra

Kur i pyeta kalimtarët
Për gjithë këtë zallamahi
Njerëzit u larguan si të stepur

Dhe iu bashkuan të lehurave

Asnjë zë më nuk dëgjuam
Te fushat e portokallishteve
I pamë zjarret e verdha
Qielli i përlotur nuk i ndalte dënesat

PRITNIN RINGJALLJEN E JUAJ IMZOT

Ç'të flasë sonte
Kur dhembja i tejkalon
Të gjitha durimet njerëzore
Kjo hënë e zgërlaqur
Paska rënë aq poshtë në këto çaste
Sa që më duket se
Mund ta prekin me dorë evgjitët e dehur

Po qajnë edhe pemët e dhunuara
Nga dhembja e rrënjëve si vullkan
Dalin mbi sipërfaqe
Shkulmat e lotëve të etërve
Dënesat e pakontrolluara
Të gjelbërimit vërshojnë
Përrenjve tëplagosur të kujtesës

Njëqind pranvera të leckosura

U zvarritën me nga një trastë të grisur
Si foshnjat qanin me ngashërim
Flamujt e përdhosur
Aq shumë kishte dhembje
Atdheu im i përbuzur
Sa që si dheut të shkrifet i gërryhej shpirti

Unë kam ndier thellë

Kam vërejtur se si qanin rrapet
Kurse nuset e mira
Frikoheshin të hynë në gjerdek
Pranë flamujve të përbuzur
Asnjëra s'donte të lindte fëmijë
Pritnin ringjalljen e Juaj Imzot

MBI TRUPIN E SAJ FLENË MAKTHET

Sa herë që tejkaloj shpejtësinë
E shoh atë zonjë
E shoh mjerimin
Me një çantë plastike në krah
Duke pritur buzë rrugës
Ta shuaj me dikë sëmundjen e epshit

Nëpër shpirtin e përdhosur
Si nëpër autostradë
Kalojnë kuajt e motorizuar të xhadeve
E në mbrëmje vonë
Troket në ndërgjegje
Dhe i numëron kalorësit e çmendur të ditës

Kështu për çdo ditë përjeton
Rrëshqitjet e gomave të shfryra
Mbi asfaltin e zi
I përjeton përbuzjet e të gjitha llojeve
Kur afrohet sterra e tunxhtë
Mbi trupin e saj flenë makthet

PËRPËLITET SI KËNDESI I PRERË

Një ditë si makthi zgjohet
Me buzëqeshjet e saja të shfrenuar
Kurse ditën tjetër
Nuk i hapet asnjë portë në jetë

Si në ndonjë çeli pa frymëmarrje
I mbyllen të gjitha shpresat
Pa asnjë ëndërr për të nesërmen
Shikon perëndimin e dyshimtë të diellit

Duke ecur si somnambul
Rrugëve të boshatisura
Takohet me pamjet anemike
Në të cilat janë mbytur të gjitha varkat

Nga arka e kujtimeve
I nxjerr vetëm ato imazhe
Që i kanë mbetur peng që nga fëmijëria

Dhe me lot drithëruese shikon të nesërmen

Më duket se asgjë tjetër
Nuk i ka mbetur
Për t'u thënë të tjerëve
Ajo me një gjakftohtësi stoike vret vetveten

Kjo heshtje e pafund në shpirtin e saj
Përpëlitet si këndesi i prerë
Çfarë të thotë të tjerëve
E çfarë i ka mbetur t'i thotë vetvetes

SHËNIME PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Disa kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret, kryesisht me poezi, që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën "Pionieri" më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës dhe të pendës, themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në kuadër të punës së këtij grupi letrar, qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës, që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Muresha. Është prezantuar

në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 – 1995, nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe.
Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1.“Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4.“Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o“Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.

12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.

21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010

28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
3o.“Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. “Zgjimi i gjëmës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010
33.“Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35.“Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

44. “Mirëmëngjes Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013
79 “ Përfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
91.”Krakëllimat e natës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. “Stina asnjanëse”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
102. “Një grusht dashuri”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
105. “Si trenat e verbër ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi,

Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2015
124. "Malli i etjes" Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
125. "Kur qajnë pemët ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
126. "Të dielave në qytetin tim ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
127. " Nëpër brigjet e kujtesës" Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
128. "Rrugës qante një stërqok", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
129. "Kali im prej bore" , Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
130. "Përballë hijes së mollës ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND ", Prishtinë, 2016
131. "Jehu i zërave", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
132. "Në kujtesën e pemëve ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND ", Prishtinë, 2016
133."Më mirë një gjysmë ëndrre ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND ", Prishtinë, 2016
134."Një dry prej dylli " Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016.
135." Në anën tjetër të mendjes", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
136."Sa shumë ethe pat dimri sivjet", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
137. "Enigmat e kashelashave ", Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
138. "Nuk i them uinë dot kësaj liri" , Poezi, Shtëpia Botuese "TREND", Prishtinë, 2016
139. "Fluturat prej letre ", Poezi,

Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
14O. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
141.“Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2016
142.“Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017.
143.“Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
144.“Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017
145.“Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
146.“Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
147.“Një stinë delikate”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
148.“Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
149.“Ishim të lumtur si gjinkallat”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
150.“Pikëllimet e rrënjëve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017

PËRMBAJTJA:

Cikli i parë
Askund nuk ishte fundi 13

Një ketër i vetmuare 15
Pikëllimet e rrënjëve 16
Unë jam nisur deri atje 18
Mbase kanë ecur edhe para meje 19
Uria mi grinte rropullitë 20
Askund nuk ishte fundi 21
Trokasim dritaret e drynave të dylltë 22
Ka kohë që nuk e pamë dritën 23
Të thashë mos i mbyllë dritaret 24

S’do të këndojnë më 25
Deri sa ta vë një gur në zemër 26
Kudo dëgjohen këlthitje nënash 27
Kjo pyetje mbase nuk ka fund 28
Me gjysmë flamuj dhe kuaj të ngordhur 30
Se sa që mund t’i shërojmë 31
Kundërmon si plaga e djeshmes 32
Ti shtatë herë ishe më i fortët 33
Të zgjohen lisat 34
Statujat 35
Nga llaçi gatuhet dita 36
Rrëshqitje gomash nëpër shi 37
Nëpër faltoret e boshatisura 38

Cikli i dytë
Përveç kollitjes së drynave 39

Përpos ikjes nga vetvetja 41
Mbi degët e thyera të kajsishtave 42
Përveç kollitjes së drynave 43
Nga të katër anët e fjalëve 44
Trokasin stërkalat e lazdruara 45
Të pavdekshmit e dikurshëm 46
Një pemë me fytyrë të zhubrosur 47
Nëpër bahçet e djegura 48
Mbështetën një arkivol të gurtë 49
Ajo me ato nëna malesh 50
Tani më është tepër vonë 51
Një zë i largët vinte nga hojet 52
Disa lloje përmendoresh 53
Deti i uritur 54
Protestoj për heshtjen njerëzore 55

Kot e dëgjuam zërin e shiut 56
Më kujtohet kur ishim të humbur 57
Era ngadalë depërton 58
Nuk kishte mbetur asnjë fjalë 59
Aq shumë e ndiqte hija e tij 60
Xhambazët e kënaqur i fërkonin duart 61
Ngjan një pjate porcelani 62
Paskan ikur patat e egra 64
Mendimet dhe dyert 65
I thyen dritat e neonit 66
U ngritën si perënditë 68
Jeta vlen dy kokrra misër 70
Shiu dhe njeriu dy miq të vjetër 71

Cikli i tretë
Kur të mbërrijmë në fund të rrugës 73

Kurse nën hapat e tua 75
Sërish jemi në vjeshtë 76
I ndeza zjarret e mëdha të dynjasë 77
Kur të mbërrijmë në fund të rrugës 78
Dymijë vjet jam në këtë varr 79
Secili plumb ngjante me vdekjen 80
Kjo hallkë e vazhdimësisë 82
Me një libër të vjetër 83
Acari kafshonte si gjarpri 84
Shiu dhe urat e thyera 85
Mbështolla koklën me një shami 86
Njerëzit u larguan si të stepur 87
Pritnin ringjalljen e juaj Imzot 88
Mbi trupin e saj flenë makthet 90
Përpëlitet si këndesi i prerë 91

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Pikëllimet e rrënjëve / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : "Trend", 2017. – 107 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-694-79-7